

Neni 45

1. Varësisht nga neni 46 deri 49, mallrat që barten në bagazhin personal të udhëtarëve që vijnë nga një vend tjetër ju lejohet lirimi nga detyrimet e importit, me kusht që këto importe nuk janë të natyrës tregtare.

2. Për qëllime të paragrafit 1:

a) Bagazh personal, nënkupton tërësinë e valixheve, të cilat udhëtari i paraqet para autoritetit doganor me rastin e arritjes së tij në Kosovë, si dhe çdo valixhe që i paraqitet këtij autoriteti në data të mëvonshme me kusht që kjo dëshmi të mund të sigurohet për të dëshmuar se është regjistruar, me rastin e nisjes së udhëtarit, si bagazh shoqërues me kompaninë që e ka transportuar në Kosovë nga vendi i nisjes.

Pa rënë ndesh me Nenin 112 (1) (b), kontejnerët portabël që mbajnë karburante nuk bëjnë pjesë në bagazhin personal;

b) Importe të natyrës jo-tregtare, nënkupton importet të cilat:

- Kanë natyrë të rastit
- përbëhet ekskluzivisht nga mallra për përdorim personal të udhëtarëve apo të familjeve të tyre apo të mallrave të destinuara për dhurata, natyra dhe sasia e të cilave nuk lënë dyshim, se janë duke u importuar për qëllime tregtare.

Neni 46

1. Lirimi i përmendur në nenin 45 (1) për mallrat e shënuara më poshtë zbatohet varësisht nga kufijt sasiore për udhëtarë, me sa vijon:

a) produkte duhani:

- 200 cigare, ose
- 100 cigarillos (cigare që peshojnë më së shumti 3 gramë secila) ose
- 50 puro ose,
- 250 gramë duhan për tymosje ose,
- Një përzierje proporcionale e këtyre produkteve të ndryshme;

b) alkool dhe pije alkoolike:

- pije të distiluara dhe alkoolike me përbërje alkooli mbi 22%; alkool etilik i padenatralizuar me përbërje alkooli 70% e mbi: një litër ose 153
- pije të distiluara alkoolike dhe alkool, si dhe aperitivë me bazë vere apo alkooli, pije tafia, sake apo pije të ngjashme alkoolike me përbërje alkooli deri në 22%; verëra shkumëzuese, verëra likerit: një litër apo një përzierje proporcionale nga këto produkte të ndryshme dhe
- Vere e pa gazuar: dy litra;

c) parfume: 50 gramë, ose ujë tualeti: 0,25 litra.

- Medikamente mjekësore: sasia e nevojshme që i përgjigjet nevojave personale të udhëtarit.

2. Lirimet për mallrat e përmendura në paragrafin 1 (a) dhe (b), nuk lejohen për udhëtarët nën moshën 17 vjeçare.

Neni 47

Lirimet e përmendura në nenin 45 lejohen deri në shumën 175 € për çdo udhëtar për mallrat tjera përveç atyre të shënuara në nenin 46.

Neni 48

Kur vlera e përgjithshme e dy a më shumë artikujve tejkalon shumën e përmendur në nenin 47, lirimi për ato shuma lejohet njëjtë sikur këta artikuj të ishin importuar ndaras, duke marrë parasysh se vlera e një artikulli të vetëm nuk mund të ndahet. <http://www.dogana-ks.org/?cid=1,59,51>